

UNIVERSITETI I GJAKOVËS “FEHMI AGANI”

FAKULTETI I FILOLOGJISË

DEGA: GJUHË SHQIPE



PUNIM DIPLOME

Leksiku në “Lahuta e Malcisë” të Gjergj Fishta

MENTORJA:

Dr.Rovena Vata

KANDIDATJA:

Besjana Jakupaj

Gjakovë, 2018

UNIVERSITETI I GJAKOVËS “FEHMI AGANI”

FAKULTETI I FILOLOGJISË

DEGA: GJUHË SHQIPE



PUNIM DIPLOME

Leksiku në “Lahuta e Malcisë” të Gjergj Fishta

Komisioni:

Kryetar \_\_\_\_\_

Anëtar \_\_\_\_\_

Anëtar \_\_\_\_\_

MENTORJA:

Dr. Rovena Vata

KANDIDATJA:

Beşjana Jakupaj

Gjakovë, 2018

## DEKLARATA E KANDIDATËS

Unë, *Besjana Jakupaj*, deklaroj se kjo temë e Diplomës e titulluar: *“Leksiku në “Lahuta e Malcisë” të Gjergj Fishta”*, e llojit të studimit: Rishikim i literaturës, është punim origjinal i imi dhe është përgatitur nga unë.

E gjithë literatura dhe burimet tjera që janë shfrytëzuar gjatë këtij punimit janë të renditura në referenca dhe plotësisht të cituara, në bazë të autorit dhe të punimit të caktuar.

Tërë ky punim është përgatitur duke respektuar rregulloren dhe duke u mbështetur në këshillat për përgatitjen e temës së diplomës të përcaktuara nga ana e Universitetit “Fehmi Agani” në Gjakovë.

## **FALËNDERIM:**

Me këtë rast dua të falënderoj profesorin time Dr. Rovena Vata e cila është edhe mentorja e këtij, punimi si dhe anëtarët e komisionit për mbrojtjen e kësaj teme për të gjitha vërejtjet dhe sygjerimet e dhëna gjatë punës dhe mundit tim për përfundimin e këtij punimi diplome.

Gjithashtu falënderoj edhe të gjithë stafin pranë Fakultetit Filologjik, dega Gjuhë Shqipe, të Universitetit “Fehmi Agani” në Gjakovë të cilët kontribuon në ngritjen time profesionale.

Gjithashtu dua të falënderoj edhe familjen time e cila nuk kursej asgjë për të më dal në përkrahje gjatë gjithë këtij rrugëtimi.

Gjithashtu falënderoj edhe kolegët për të gjithë përkrahjen morale gjatë tërë kësaj kohe.

## PASQYRA E LËNDËS:

<b>HYRJE</b> .....	<b>6</b>
1. Objekti dhe motivimi i temës .....	6
2. Metodologjia dhe metodat e punës .....	6
3. Baza teorike e punimit.....	7
4. Synimi i temës.....	7

### KREU I

<b>Periudhat e studimit të veprës fishtjane</b> .....	<b>9</b>
1.1 Periudha e parë.....	9
1.2 Periudha e dytë .....	10
1.3 Periudha e tretë.....	10

### KREU II

<b>Struktura e funksioni i figuracionit të <i>Lahuta e Malcís</i>: koncepte teorike dhe hulumtim tekstori</b> .....	<b>14</b>
2.1 Metaplazma.....	14
2.2 Metataksa.....	15

### KREU III

<b>Hiperbola si figurë e rëndësishme e poetikës së Fishtës në epikë: funksioni i saj</b> .....	<b>20</b>
3.1 Rastet e ndërtimit të hiperbolës në <i>Lahutën e Malcís</i> .....	22
3.2 Krahasimi si figurë e rëndësishme e poetikës së Fishtës në epikë: funksioni i tij	23
3.3. Rastet e ndërtimit të krahasimit në <i>Lahutën e Malcís</i> .....	26

<b>PËRFUNDIME:</b> .....	<b>29</b>
--------------------------	-----------

<b>BIBLIOGRAFIA:</b> .....	<b>30</b>
----------------------------	-----------

# HYRJE

## 1. Objekti dhe motivimi i temës

Ky punim diplome paraqet një studim mbi poemën epike *Lahuta e Malcís* të Gjergj Fishtës. Synimi i këtij kërkimi ka qenë që të fokusohemi në strukturën, funksionin dhe tipologjinë e këtyre figurave.

Hiperbola dhe krahasimi përgjatë periudhave të ndryshme studimore mbi Fishtën, nuk janë trajtuar me interesin e duhur specifik që paraqesin këto trope. Pastaj këto dy figura janë krahasuar me tri vepra të tjera: *Eposin i kreshnikëve*, *Iliadën* e Homerit (përkthimin e librit V nga vetë Fishta), *Kunorën e maleve* të Njegoshit, për nga ana e strukturës dhe funksionit që transmetojnë. Në këtë mënyrë ne kemi dalluar aspektin organizativ të tropeve si dhe diferencat përkatëse.

Interesi thelbësor i yni, ishte që të identifikonim rrafshin ndërtimor në poemën *Lahuta e Malcís*, duke e ilustruar me shembuj përkatës çdo tipologji të evidentuar. Në lidhje me intensitetin e përdorimit të figurave kemi paraqitur një vjelje të sekuencave konstruktive, të cilën e kemi dhënë në shtojcat gjegjëse.

*Fjalë kyçe: sekuencë, poemë, epikë, gjurmë krahasimi, etj.*

## 2. Metodologjia dhe metodat e punës

Burimi kryesorë i të dhënave për realizimin e këtij punimi ka qenë kërkimi në literatura. Metoda e grumbullimit të të dhënave është e tipit rishqyrtim literature. Është shfrytëzuar literaturë e mjaftueshme nga biblioteka e universitetit dhe burime të ndryshme shkencore nga interneti. Literatura është përzgjedhur në bazë të problematikës që shtjellohet në punim.

Literatura është përzgjedhur në bazë të këtyre kriterëve:

- Titullit të temës e cila është marrë,
- Fjalëve kyqe që janë përdorur për kërkime në internet,
- Librave leksikor,
- Të dhënat e marra dhe
- Propozime të marra nga ana e Mentorit tim.

### 3. Baza teorike e punimit

Ky punim diplome, jo vetëm se me të plotësonim një detyrim të domosdoshëm nga fakulteti filologjik, por edhe në ato qindra e mijëra tituj punimesh mbi Fishtën vihen re njëherësh disa prirje të qasjeve ndaj veprës së tij, disa lloje tekstesh shkencore, disa metoda teorike të trajtimit të çështjeve. I gjendur para një literature të tillë, historiani i letërisë, nuk mund të rrijë pa u përpjekur të bëjë një klasifikim bibliografik të saj dhe ç'është më e rëndësishmja, të përzgjedhë në ato mijëra faqe vështrimesh, analizash e pikëpamjesh më të vyera.

Ishte teoria e praktika e shtetit totalitar të godiste çdo devijim nga platforma e realizimit socialist dhe/ose çdo veprimtari e praktikë fetare të përfaqësuesve të religjioneve të ndryshme.

Interesimet mbi Shënimet estetike të Fishtës fillojnë seriozisht me P. Asllanin, e cila përgatiti antologjinë *Fishta Estetikë dhe Kritikë*, (Tiranë, 1999). Antologjia është e shoqëruar me studimin *hyrës Fishta meditant*, nga A. Plasari, që flet për parimet dhe kategoritë estetiko-filozofike të autorit, marrëdhëniet dhe ndikimet e tij nga filozofë botëror, teoritë e praktikat krijuese origjinale.

Tipologjia dhe llojet e lirikës së Fishtës, klasifikimi sipas temës, vargut dhe strofës dhe llojet formale të lirikës paraqiten përmes vëzhgimesh të imta teorika dhe shëmbëlimesh konkrete nga poezia e autorit. Për studiuesin pjesën më të madhe të poezisë lirike (atë patriotike), Fishta e shkruan sipas traditës rilindase, përmes ligjerimit thirror, i cili ngaqë ka parasysht auditorin, i drejtohet drejtpërdrejt. Ligjërimit himnizues, predikues, vajtues, dëshpërues, mallkues, didaktik, moralizues, bisedor, ironizues etj., janë tipet e tjera të ligjërimit lirik të Fishtës.

### 4. Synimi i temës

Tradita fishtologjike, ka bërë pjesë të vetën studimore një sërë figurash që gjenden në *Lahutën e Malcís*, por gjithherë një qasje e tillë ka qenë rezultat i një hulumtimi jo specifik. Kjo apo ajo figurë, në mënyrë të përgjithshme ka gjetur trajtim në studimet e mëhershme. Mundësisht ka shërbyer si shtojcë kapitujsh apo në raste të rralla, si kapituj të mëvetësishëm. Vepra madhore e Fishtës, ç'është e vërteta ka nevojë për një kërkim të posaçëm mbi figurat retorike. Para së gjithash, tradita duhet ndarë në tri periudha studimore-historike për veprën e plotë të Gjergj Fishtës, megjithëse në veçanti neve na intereson *Lahuta e Malcís*:

- a) *studime deri në '44*
- b) *studime jovendore*

c) *studime pas '90.*

Në ndarjen e parë, përfshihen së shumti artikuj, botuar në organe të ndryshme brenda e jashtë vendit; fare pak natyra monografike si rasti i Fulvio Kordinjanos (Fulvio Cordignano), deri kur vjen mandej koha e centralizimit të pushtetit komunist. Në total, një kohë gati 40 vjeçare, duke marrë parasysh vitin e botimit të blenit të parë të kësaj vepre më 1905 Në këtë fazë – por dhe në të tjerat, ku më shumë e ku më pak – vend të madh zënë artikujt memuaristikë/përkujtimorë. Vëmendja jonë përqendrohet, natyrisht, vetëm tek ata artikuj, trajtesa, tek të cilët vërehet gjykimi letrar e madje ngushtas në përputhje me objektin tonë shkencor. Ndarja e dytë, përfshin harkun kohor 1945-1990, në të cilin studimet përgjithësisht janë kryer prej studiuesve jashtë kufijve të Shqipërisë, si: Koliqi, Botilioni (Bottiglioni), Camaj, Gradilione etj. Kryesisht “Shêjzat” (“Le Pleiadi”) e ka më të plotë trajtesën mbi Fishtë, po jo vetëm kjo revistë, mbasi ka nisma të ndryshme botimesh edhe nga organe të tjera. Kurse artikujt e politizuar të socrealizmit (ata pak sa janë dhe pjesët deskriptive të HLSH), nuk do t’i konsiderojmë kërkime përkuese me interesat e drejtpërdrejta letrare të produktit fishtian. Megjithatë vitet ’45 përfshijnë edhe zëra opozitarë (si S. Malëshova) për qëndrimin antirecensional të Fishtës gjatë Konferencave të ndryshme, akteve të ndryshme, por kjo në fakt i takon qëndrimit të përgjithshëm mbi poetin dhe nuk përbën tregues të rëndësishëm për kahen tonë qasëse. Nuk përfshijmë kështu, në këtë periudhë, as monografinë e Vehbi Balës, e mbetur e pabotuar qysh në ’61, deri me përmbysjen e regjimit çka në të vërtetë, botimi postume me ndërhyrjet gjegjëse, na largon edhe nga studimi origjinar, përveçse gjuhësisht. Ndarja e tretë, përfshin studimet fishtiane, mbi dy dekada, që nga vitet 90 e këndeje. Përveç artikujve, vërehet një pasurim i studimeve monografike. Por në këto tri periudha studimore, që përfshijnë një hark kohor të konsiderueshëm (mbi një shekull) lidhur me *Lahutën e Malcís*, trajtimi specifik i figurës letrare nuk ka gjetur ende vendin e duhur. Periudha e tretë, duhej të ishte më e prirë për ta realizuar këtë, duke u nisur nga kërkesat e interesat e tjera shkencore. Me fjalë të tjera, kësaj vepre letrare do t’i shërbente një *studim tropologjik*, në mënyrë që të kthjellohen aspektet kompozicionale në këtë drejtim, si dhe karakteristika e përgjithshme e vargëzimit. Objekti studimor të jetë sa më i ngushtë, në mënyrë që të identifikohet me kritere të duhura përfaqja e tropeve në tekstin në fjalë. Në rastin tonë, trajtimi i disa figurave që gjenden në *Lahutë*, – pra duke u shmangur prej objektit tonë thelbësor, – nuk ka qëllim përthellues në evidentimin funksional e strukturor të tyre, por kërkon të jetë një *parargumentim* i punës sonë. Përpara se të shkojmë në këtë çështje, do të trajtojmë tri periudhat receptimin kritik mbi veprën e Gjergj Fishtës.



# KREU I

## Periudhat e studimit të veprës fishtjane

### 1.1 Periudha e parë

Siç e shprehem, një kritikë specifike në mënyrë të mirëfilltë mbi hiperbolën dhe krahasimin në të tri periudhat, nuk është se dallohet shumë. Aq më tepër në periudhën e parë, në të cilën kritika përgjithësisht përqendrohej rreth hetimit të vlerave nacionaliste të poemës (qoftë edhe blejve të mëhershëm të *Lahutës*) dhe kryesisht ajo (kritika) sundohej nga një përcjellje euforike e superlativiste, për produktin fishtian. Kjo natyrisht, vjen edhe prej kushteve historike të vendit tonë. Më fort ishte një kritikë që interesohej mbi frymën e veprës (këngëve/blejve), sesa mbi konstruktin e lëndës, mbi figurativitetin dhe rëndësinë e veçantë të figurave në vepër. Në mbështetje të këtij argumenti, faktikisht na vjen edhe artikulli i Kolë Kamsit i po kësaj faze (fundit të saj, 1941), i cili shkruan se: “përmbi poezitë e Fishtës e mbi poemën epik “Lahuta e Malcis,, përveç ndonji gjykimi e komentimi të shkurtë të botuem ndër fletore e në ndonji të përkohëshme, e studimit të A. Fulv Cordignano-s përmbi epopén tonë kombtare, nuk është ende një analizë si kush, një kritikë shkencore e matun dhe e plotsueme”<sup>1</sup>.

Ajo çka duhet shënuar në këtë periudhë të parë, veç tjerash, është interesimi për botime të gjithmbarshme të krijimtarisë së Fishtës. Në të vërtetë deri në maj të 1944, *HD* (nr. i fundit i këtij organi) boton edhe fragmente veprash postume të poetit. Të fundit janë fragmente nga produkti satirik: *Nikolejda – III Odisea* dhe *IV Exodon*.<sup>2</sup> Kurse kritika nuk është në të njëjtin ritëm me botimin e veprës së këtij autori. Stabilizimi i artikujve mbi Fishtën në përmbledhjet e At B. Demës dhe revistës “Shkëndija”, është mbase momenti më madhor i botimit kritik për larminë e këndshikimeve ndaj veprës së tij në këtë periudhë<sup>3</sup>.

<sup>1</sup> Kolë Kamsi, “Vepra poetike e Fishtës e kritika”, përfshirë në: At Benedikt Dema, O. F. M., *At Gjergj Fishta O. F. M. 1871-1940...*, f. 171.

<sup>2</sup> Khs. *HD*, vjeti XX, nr. 5, Máj 1944, ff. 19-27.

<sup>3</sup> Ka botime artikujsh (përmbledhje) edhe të mëpërparshëm se këto, siç kemi rastin e *HD*, vjeti VII, nr. 10, Tetuer 1931. Përmbledhje artikujsh në nderim të 60 vjetorit të lindjes së Fishtës. Duke qenë ende para botimit përfundimtar të *Lahutës*, ky numër i kësaj reviste, paraqitet më i paplotë sesa ato realizuar mbase vdekjes së autorit të saj.

## 1.2 Periudha e dytë

Në periudhën e dytë, studimet, trajtesat a çdo nivel tjetër kërkimor mbi veprën *Lahuta e Malcís*, vijojnë ta kenë shumë pak në qendër të vëmendjes studimin e rrafshit figuracional në këtë poemë. Kryesisht hulumtimet janë të prira të gjejnë pikëtakime me letërsi të tjera, të dallojnë konvergjenca tipologjike të poemës apo hetimi të shtrihet mbi kërkime të shprehjes poetike të autorit. Kjo periudhë, sipas Lili Sulës “*vlerësohet si më e varfra në krahasim me dy periudhat e tjera*”<sup>4</sup> për shkak të mungesës së receptimit të duhur në fazën e sundimit totalitar. Në këtë fazë të kërkimeve fishtologjike, kryer jashtë vendit, fazë në të cilën përfshihen dhe Koliqi e Camaj, as këta dy të fundit nuk është i kushtojnë interes aspektit figuracional në strukturë e funksion tek *Lahuta e Malcís*. Koliqi ka disa shkrime mbi Fishtën dhe ndalet në shumë rrafshe të ndryshme mbi poetikën e *L. M.*, duke dhënë një ndihmesë të mëtejshme në hulumtimin shkencor mbi veprën e këtij autori, por interesi i tij është ekstratopologjik. Po kështu ngjet dhe me Camajn,<sup>5</sup> i cili heton mjaft mirë disa detaje përbashkësore mes Fishtës dhe traditës para tij, sa i takon shprehësisë poetike, megjithëse nuk është fusha e tij parësore e kontributit (studimi kritik mbi veprën e Fishtës).

## 1.3 Periudha e tretë

Periudha e tretë e kritikës mbi Fishtën, ka një pamje tjetër në krahasim me dy periudhat e tjera, sa i përket qasjes dhe rezultateve shkencore, të cilat janë të vlefshme për fushën e studimeve të letërsisë shqipe. Bie në sy, përpos konferencave të ndryshme, artikujve mbi veprën e këtij autori, kontributi me studime të ndryshme monografike siç e cekem. Këtu po paraqesim disa nga studiuesit, të cilët ndër të tjera kanë trajtuar në veprat e tyre figurën e hiperbolës dhe krahasimit.

Xh. Aliçkaj në studimin e tij *Lahuta e Malcís e Gjergj Fishtës*, figuracionit në *Lahutë* i kushton një kapitull të posaçëm: “Struktura e figuracionit poetik”. Përpara se të shkojë tek analizat strukturore e funksionale të figurave ai bën një klasifikim figurash, që i ndan kësodore: a) figura tingullore, b) figura të fjalorit, c) figura të fjalës (trope), d) figura të

---

<sup>4</sup> Lili Sula, “Receptimi kritik i Fishtës në periudhën 1944-1990” në: *Fishta - poeti dhe mendimtari kombëtar*, Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, Fakulteti i Shkencave Shoqërore, Studime shqiptare 18, Shkodër, 2011, f. 106.

<sup>5</sup> Martin Camaj, “Shëndrrimi e përpunimi i thanjeve popullore në *Lahutën e Malcís*”, “Shêjzat”/“Le Pleiadi”, Anno V, Romë, 1961/11-12 dhe Martin Camaj, “Kumtime të reja mbi Fishtën”, “Shêjzat”/“Le Pleiadi”, Romë, 1962/9-10.

sintaksës, e) figura të kuptimit.<sup>6</sup> Autori pohon se më e parapëlqyera ndër figurat e Fishtës është krahasimi, i cili “*përdoret në formën e krahasimit të mjeteve, objekteve dhe të dukurive krahasuese*”.<sup>7</sup> Kjo është një figurë, e cila – mendon studiuesi në fjalë, – ka si funksion bazik shpërfaqjen e cilësive të protagonistëve. Mirëpo, në shumë vargje të poemës, kjo figurë del në të njëjtin funksion edhe për antagonistët. Kemi rastin e Knjaz Nikollës, i cili në këngën IV, *Vranina*, paraqitet me anën e një krahasimi në diskutimin që shtron përpara të vetëve: “*Ngerthye vetllat m’shtek të ballit, / Folë u paska si tue ulrue*”. Ndërsa edhe krerët malazezë, në përshkrimin e Fishtës, katër vargje më sipër janë: “*(Thirrka Krenët e Malit t’Zi:) / Njani arí, tjetri duhí*”. Domethënë përfaqësuesit e Malit të Zi janë *(si) arí* dhe *(si) duhí*. Për nga ana teknike, tek ky varg kemi edhe prani të *vargut leonin*, i ndarë në dy hemistikë katërrokësh, që ndërtojnë tetërrokëshin, të cilin do të kemi rastin ta trajtojmë në vijim. Megjithatë skema hemistikore e këtij vargu këtu është (3, 5) për shkak të elizionit: “*njani arí*” dhe rrokjen e 8-të e ndërton fjala oksitone: *duhí*.

Me të drejtë, në shtjellimin e tij, Aliçkaj thotë se, struktura e krahasimit lidhet me mitologjinë, dukuritë natyrore, botën shtazore etj. Shembujt e vargjeve që merr për ilustrim u përgjigjën idesë së tij për strukturën e funksionin e krahasimit. E njëjta vijimësi konceptuale është edhe për figurën e hiperbolës, po ilustrimet janë më të pakta dhe trajtesa është më e thukët sesa për krahasimin. Duke lënë figurat e tjera mënjanë të trajtuara nga Aliçkaj, këto dy figura në përgjithësi sjellin qëndrim lëvdues për përdorueshmërinë fishtiane. Nuk është se kemi një përimitim figuracional (të krahasimit e të hiperbolës) dhe evidencë ndërtimore e llojore. Për shembull për figurën e krahasimit, nuk bëhet ndarja në llojet e tij. Një ndarje të tillë do ta bëjë, Bajram Kosumi në veprën *Fishta dhe tradita letrare shqiptare*.<sup>8</sup>

Këtu studiuesi, dallon:

1. *modelin elementar të krahasimit* (krahasim mes dy objekteve) me anë të lidhëzave *si, sikur, porsí, sikurse* etj., i cili është mjaft i ndeshur në traditën tonë letrare (qoftë edhe parafishtiane);
2. *krahasimin sasiar* (krahasimi i zgjeruar; dendësimi i kuptimit ndërmjet objekteve të krahasuara);
3. *krahasimin cilësor* (krahasimi i situatës me një tjetër apo një veprimi me një tjetër).<sup>9</sup>

Megjithatë edhe ky klasifikim është shumë pak i trajtuar e i shpjeguar në veprën e Kosumit, sikundër figura e hiperbolës (tek e cila dallon: *hiperbolën himnizuese, pezhorative,*

<sup>6</sup> Dr. Xhavit Aliçkaj, *Lahuta e Malcis e Gjergj Fishtës*, Faik Konica, Prishtinë, 2000, f. 226.

<sup>7</sup> Po aty, fq. 227

<sup>8</sup> Bajram Kosumi, *Fishta dhe tradita letrare shqiptare*, Brezi 81, Prishtinë, 2012.

<sup>9</sup> Po aty, fq. 330

ironizuese).<sup>10</sup> Gjatë procedimit me punën tonë do ta dallojmë krahasimin *cilësor* e *sasior* në një mënyrë tjetër. Po kështu dhe *gjurmët e krahasimit* të cilat kanë një paraqitje të shpeshtë në *Lahutën e Malcís*. Ndërsa, figurës së similitudës do i japim vend të veçantë, si trajtë ndërtimore në diskursin e poetit. Në studimin e tij, Kosumi në kapitullin III “Fishta dhe Romantizmi”, parashton trajtimin dhe konstatimin njëherësh për korpusin e figurave të parapëlqyera të Fishtës: “Në fund duhet të flasim për modelin më të preferuar të Fishtës në figurën poetike. Si do të shohim më vonë, figura e zgjeruar, qoftë ajo krahasim, metaforë, metonimi, hiperbolë etj., është figura më e arrirë e Fishtës”.<sup>11</sup> Ripërsëritet i njëjti mendim për korpusin e përdorimit të figurave në f. 192.<sup>12</sup> Sërish, në vijim, kemi një konstatim për figurën e hiperbolës, e cila studiuesit i rezultojnë më karakteristika në përdorim, përpos se në epikë edhe në gjinitë e tjera letrare të cilat i ka lëvruar Fishta.<sup>13</sup> Lidhur me përdorimin e hiperbolës, S. Hamiti sjell një konstatim që nuk na duket se e përlligj krejt lëndën e poemës epike *Lahuta e Malcís*, në rastin kur ai shprehet se: “hiperbola është e ndërtuar gjithmonë mbi një krahasim, pra me bazë krahasimin”.<sup>14</sup> Studiuesi për ilustrim, jep disa vargje prej këngës *Lugati*, që në fakt janë vargje krejt në përputhje me mendimin e tij. Por në të vërtetë, ka edhe vargje të tjera në *L. M.*, ku hiperbola funksionon si mëvetore ose në korrelatë me figura tjera letrare; pra, jo gjithmonë baza ndërtimore e hiperbolës është në krahasim. Kemi shembullin e këtyre vargjeve:

*Gjaku rrmë nper rrahe e qare, E nper fusha e nper gajusha*

(L. M., I, f. 7)

*Ká thekë kambët aj sá mund heci : [kâmbët] Ká lânë mbrapa fushë e zalle Kapercye ká bjeshkë e male, Edhë dalë ká lum e shé : Ká shtegtue per ujë e dhé, Dér qi 'i ditë, tue marrun dilli, Në Cetinë ká behë aj filli : Shtjerrë opangat, grisun setren : (etj.)*

(L. M., I, f. 11)

ku me sa shihet prej këtyre, baza mbi të cilën mbështet hiperbola, nuk është krahasimi por kryesisht sundon metaloba e metataksës: polisindetit. Po ashtu dukshëm dhe metafora, e pak anafora. Të tjerë shembuj po të kërkojmë në vepër, mund të gjejmë përsëri. Aspekti i ndërshkrirjeve, apo shoqërimeve të ndryshme të metabolave, që u përkasin njërit apo tjetrit rreth, do të gjejnë hapësirë trajtimore në një moment tjetër. Kurse në veprën e fundit të tij, S.

<sup>10</sup> Po aty, fq. 199-200

<sup>11</sup> Bajram Kosumi, *Fishta dhe letërsia shqiptare e traditës*, botimet Filozofia Urbane, Prishtinë, 2013, f. 108.

<sup>12</sup> Po aty.

<sup>13</sup> “Hiperbola është figura më karakteristike e Fishtës dhe ajo shpreh gjërat më të mëdha sesa janë në përmasat reale, shpreh madhësinë dhe botën e madhe shqiptare”, B. Kosumi, *Fishta dhe letërsia...*, *ibid.*, f. 280.

<sup>14</sup> Sabri Hamiti, *Studime letrare*, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës. Botime të veçanta XLIX, Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Libri 21, Prishtinë, 2003, f. 218.

Hamiti pohon: “*Figura dominante e veprës epike të lavdit nacional [kuptojmë Lahutën e Malcís, L. K.] është hiperbola*”.<sup>15</sup>

Gjatë hulumtimit tonë për raportin e traditës kritike mbi veprën *Lahuta e Malcís* me praninë e figurës së hiperbolës dhe krahasimit, na rezulton se periudha e tretë studimore (një kohështrirje mbi dy dekada) e ka më të integruar, në ato vepra që përmendem, trajtesën mbi figurat në fjalë. Kjo është një periudhë me pritshmëri më të mëdha shkencore, dhe me rezultate më të dukshme në krahasim me dy periudhat e tjera, për studimin e veprës së Fishtës. Por, me sa duket interesi shkencor është fokusuar në objektiva të tjera për sa i takon çështjes së lëndës fishtiane. Mungon, kështu, një punë e thelluar dhe klasifikuese e prezencës së tropeve në fushën e studimeve letrare shqipe në krejt produktin e Fishtës, jo vetëm në *Lahutë*.

---

<sup>15</sup> Sabri Hamiti, *Utopia letrare*, Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës, botime të veçanta CXXIX, Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Libri 49, Prishtinë, 2013, f. 261.

## KREU II

### Struktura e funksioni i figuracionit te *Lahuta e Malcís*: koncepte teorike dhe hulumtim tekstor

Në veprën *Lahuta e Malcís*, gjenden një sërë figurash (tropesh) që përftohen nga shndërrimet e caktuara gjuhësore, për t'u përshtatur me efektet poetike dhe tekstit i japin një status, i cili bëhet kahe studimore. Këto shndërrime gjuhësore me dukuri letrare njëherësh (metabola), i japin poemës një integritet të larmishëm. Praninë e figurave retorike që ndodhen në veprën e Fishtës, do t'i klasifikojmë në katër grupe:

- a. *metaplazma*,
- b. *metataksa*,
- c. *metasemema*,
- d. *metalogjizma*.

#### 2.1 Metaplazma

Është një dukuri tjetërsuese e fjalës (për pasojë edhe trajtës së shprehjes), e cila sjell një shndërrim fonetik ose grafik. Fjalës kështu, i dallojmë dy nivele: 1. *nivelin fonetik* (niveli *f*), 2. *nivelin grafik* (niveli *g*). Domethënë, metabolat kur shndërrohen në nivel *f*, sjellin modifikime edhe në nivelin *g*. Por kjo nuk është gjithmonë e përligjshme, pasi ka raste që s'kemi përputhshmëri mes trajtës së shkruar e asaj të shqiptuar. Ka raste që fjala ka vetëm vlerë si substancë grafike. Tek Fishta në *Lahutën e Malcís* dhe vepra të tjera, kemi rastin e fjalës *Mbret*, e cila shënohet me gërmë të madhe ose rastin tjetër: *Karadak*. Në rastin kur njëra ose tjetra shqiptohen apo artikuloohen si fjalë, nuk është se del me specifika të veçanta, sepse është një emër i përgjithshëm, por tek autori ynë del si i përveçëm. Gjithsesi nuk është saktësisht çështja për këtë aspekt mospërputhjeje. Shumë fjalë tek Fishta kanë një paraqitje grafike, që kontrastohen me shqiptimin normal të tyre. Kështu kemi shembullin e shkrimit *kamot* në vend të *kahmot*. Shndërrimi në këtë fazë, është vetëm viziv. Siç na krijon të njëjtën gjë, përngjitja e tre elementeve në vargun: “*Pse kjo mâ morekujé!*” (L. M., XXIV, f. 380), fjalë me anë të së cilës ndërtohet pashirra. Sidoqoftë, ky është një tregues që nuk e ndryshon përmbajtjen e mesazhit, prandaj nuk do ndalemi më gjatë. Lidhur me trajta grafike të caktuara si *mshirë* (për *mshirë*), do t'i konsiderojmë si metagrafe të arkaikizuara, për shkak të mosgjegjësisë në trajtën e sotme të fjalës, në të shkruar: në variantin gegë dhe në atë standard. Po kështu: *sajë* (në vend të *saj*); *kuprrac* (në vend të *koprrac*).

*Rima*, si pjesë e kategorisë së *shtesës përsëritëse*, konsiderohet si një dukuri e rregulluar në bashkësi fonetike të barasvlerëshme apo barazi homofone e zanores së fundit të theksuar në varg dhe fonemave që dalin aty të pranishme.<sup>16</sup> Ajo është një *dukuri përsëritëse* e një strukture fonemore, e cila i nënshtrohet një shndërrimi të dhënë. Në *Lahutë* kryesisht kemi këto lloj rimash: *rimë të puthur, të alternuar, asonantike*, me raste *konsonantike, identike* (ose *tautologjike*<sup>17</sup>), po ashtu dhe *rimë të brendshme / brendavargore* etj. Teknikë e veçantë e rimarit fishtian në këtë vepër, është rima e puthur, e cila del deri mbi shtatë a më shumë<sup>18</sup> vargje me të njëjtën strukturë fonemore përsëritëse. Këngët e poemës *Lahuta e Malcís*, nuk ruajnë të njëjtën skemë rimimi, sepse ka raste kur ndërfitet një tjetër rimë, ose vargjet dalin të parimuara. Si shembuj të rimës së puthur mund të shohim:

*Gegë e Toskë, Shqypnija marë [mbarë] Prap se prap quhen « Shqyptarë ». Medjë kta, zotni të mí, Njitash s' voni i a kan hí*

*Me shkrue shqyp libra e fletore, Me çilë shkolla n'giuhë arbnore : (L. M., XXVII, f. 450)*

Kurse si rimë të alternuar mund të vërejmë këto vargje:

*Vrap tue shkue nder shpija t' veta, Gjindes s' vet per ngiat m' i u gjetë : Edhë kshtû tash Tringa e shkreta Qyqe n' shpi me t' vllán ká mbetë (etj.) (L. M., XXII, f. 312)*

Rima e brendshme dallohet në një sërë vargjesh:

“*Hikin derrat, // marrin ferrat*”; “*Por shka, Zot, // ka Mashit sot*” “*Qi na â vrâ // e nuk bân zâ?*” etj. Si raste të rimës asonantike mund të citojmë këto vargje:

*Kshtû lshue dore prej gjithkuej ? [...] Un veç n'shkosha me u mbytë n'ujë !*

(L. M., XXII, f. 313)

## 2.2 Metataksa

Si grup i dytë i klasifikimit të tropeve, përfshin figurat që ndryshojnë strukturën e frazës. Në rastin tonë strukturën e vargut të poemës *Lahuta e Malcís*. Në kategorinë e heqjes tërësore rendisim *elipsën*, si figurë e cila pranon eliminimin e një a ma shumë gjymtyrëve në fjali. Si vargje për ta shembullzuar këtë figurë, mund të marrim:

<sup>16</sup> Akademia e Shkencave, Instituti i gjuhësisë dhe i letërsisë, Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Filologjisë, Seminari XVIII ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare, Toëna, Tiranë, 1996, f. 1023.

<sup>17</sup> “*fjalë që rimon me veten e saj*”, shih: Arshi Pipa, *Vargu folklorik shqip: ndërtimi dhe gjinitë*, [Trilogjia Albanika I], përk.: Primo Shllaku, Princi, Tiranë, 2013, f. 24.

<sup>18</sup> Po aty, Arshi Pipa, fq. 21.

*Ora e Zana ashtë perlá, Ç' t' janë dermishë shoqe me shoqe ! M' dhâmë [dhâmbë] e m' thoj se ç' janë lvyrë ! Ç' po u shkon gjaku rrkajë nper ftyrë ! ~ Fluturim neper ajri, Idhtë n' mjet vedit kapërthye*

(L. M., XXV, f. 429)


Siç shihet në shenjën (~), kemi një mungesë të gjymtyrës së foljes, e cila në këtë rast del si pjesë munguese e vargut. Këtu poeti ka realizuar një shlyerje tërësore të një strukture, duke përfutur një tjetër imazh, i cili ndërtimisht për kah ana logjike e formulimit të fjalisë sjell një rezultat shndërrimi. Folja e hequr këtu, mund të ishte *ikin/shkojnë*, por vullneti autorial dëshmon për vetëdije *fshirjeje* (cancellazione) e jo për shtrëngesë së masës metrike. Themi kështu, sepse Fishta mund të kishte gjetur zgjidhje të tjera për të ndërtuar tetërrokëshin, për pa e përdorur fare elipsën. Për shembull nëse vargu do të ishte: “*Shkojn flutrim neper ajrë*”, do të kishim një rezultat të rregullt metrikisht. Por ajo çka çmohet në këtë rast, është motivimi stilistik që e përllig praninë e elipsës. Si rast tjetër mund të shohim dhe vargjet e mëposhtme:

*Pa na pasë ti gjak as varrë, Ne ~ pré mik, ne erzin ~ marrë, (Ne as na ke pré mik, ne as erzin s'na ke marrë) As thye ví, as luejtë kufí, Veç e pse ti Shkjá ké lé, Edhè bân hije mbí dhé etj.*

Po të sajojmë një paraqitje të thjeshtë do të kemi këtë rezultat:

**p. a<sup>1</sup>** M' pushkë e m' top gjueju batare

Gjaku rrmë nper rrahe e qare **p. a<sup>2</sup>**



**p. m.** E si derrat me çakalla

Një shembull i kiazms mund të vërehet në vargjet:

*Se ç' âsht hjedhë qaj Dash Galani:*

*Dash Galani se ç' âsht hjedhë*

(L. M., XX, f. 263)



Përpara se të shkojmë në familjen e *metasememës*, duhet shpjeguar neologjizmi i përfutur nga studiuesit e Grupit μ. Termi “metasememë” vjen si simetri emërtimi me krejt ndarjet e tjera, që i shënuam më sipër. Por, termi përshtatet dhe për hir të procedimit të punës së studiuesve. Kështu, me metasemema do të kuptojmë atë korpus figurash që tradita e hershme i ka klasifikuar si *trope* apo thënë ndryshe *figura të fjalës*. Përndryshe, “*metasemema është një figurë që vendos një sememë në vend të një tjetre*” dhe në këtë pikë *semema* lipset të shihet në pikëpamjen e semantikës strukturale, siç na bën me dije studiuesja Briçe Mortara Garaveli (Brice Mortara Garavelli). Kjo e fundit pohon se “*semema është tërësia e veçorive semantike, e realizuar në rrafshin leksikor si leksemë*”.

Në këtë ndarje bëjnë pjesë *sinekdoka* (e përgjithshme dhe e përveçme) së bashku me *antonomazinë*. Rasti i sinekdokës në *Lahutën e Malcís*, do të kërkonte një hulumtim tjetër më specifik në evidentimin e kësaj figure dhe në dhënien e shembujve. Por gjithsesi në një ekzaminim të shpejtë të kësaj figure mund të evidentonim vargjet: “*I rá pushka rranzë gabzherrit / E e lshoi dekun terthuer djerrit*”, në të cilët vargu i parë është përdorur në trajtë figurative “*i ra pushka*” për të treguar se “njeriu është ai që ka qëlluar me pushkë” duke e vrarë atë tjetrin e kështu me radhë. Ndërsa për rastin e antonomazisë,<sup>19</sup> ilustrimi më i menjëhershëm që do të na vinte në mendje, pa bërë një kërkim të hollësishëm, mund të ishte përdorimi i leksemës *cubi/at* që nënkupton antagonistët. Shembuj të tjerë, pastaj, po të kërkonim mund të gjenim sërish.

*Metafora*, figura tjetër që përfshihet në klasën e metasememave, në vështrimin e studiuesve të Grupit μ, nuk është thjesht një zëvendësim i kuptimit por një modifikim i përmbajtjes semantike të një fjale.<sup>20</sup> Si shembuj të përdorimit të kësaj figure, mund të marrim:

“*N’ at log Deká ká vllaznue .:*”; “*Pater Gjoni, njeshë m’ litár*”


(*L. M.*, XX, ff. 277; 280).

Ka raste kur kjo figurë është e shoqëruar me figura të tjera të kësaj familjeje (metasememave), si sinekdoka, metonimia a oksimoroni. Për shembull një bashkëshoqërim i figurës së metaforës me sinekdokën, na rezulton dhe vargu që morëm si ilustrim: “*Pater Gjoni, njeshë m’ litár*”, çka nënkuptohet në vend të zhguni të fratit, “njeshja”

<sup>19</sup> J. A. Cuddon, (revised by C. E. Preston) *Dictionary of literary terms and literary theory*, Penguin books, England, 1999, f. 47: “*antonomasia (Gk ‘naming instead’) A figure of speech in which an epithet, or the name of an office or dignity is substituted for a proper name*”.

<sup>20</sup> Khs. për më shumë Gruppo μ, *ibid.*, f. 161.

(lidhja/shtrëngimi) me litarin e bardhë. Kështu fjala *litar* vetvetiu shpërbëhet në disa kuptime që qëndrojnë pas saj:



Rrethi i metalogjizmave përfshin atë pjesë figurash, të cilat në hershmëri janë quajtur “*figura të mendimit*”. Ky grup figurash tjetëron vlerën logjike të frazës. Nisur nga përcaktimi i “metabolës”, metalogjizmat në fakt nuk përbëjnë mirëfilli një tjetërsim sikundër tri familjet e tjera, që pamë më sipër. Por ato (metalogjizmat) duke u shoqëruar me metasememat – pra duke pasur një përmbajtje semantike – ndërtojnë shndërrimin gjuhësor, marrëdhëniet mes kuptimit, domethënies etj. Sipas përkufizimit të Grupit  $\mu$ , metalogjizmat në veçanti janë përvijime, mekanizma që mund të përforcojnë, një veprim metasemematik.<sup>21</sup>

Në ndarjen e parë, te *heqja e pjesshme*, në rrethin e metalogjizmave përfshihet *litota*. Kjo figurë përdoret për të nënkuptuar diçka më të përzvogëluar, në raport me realitetin. Shndërrimi është i pjesshëm, sepse kryhet një heqje e pjesshme e semave (njësia më e vogël e kuptimit). Ka raste kur nëpërmjet kësaj figure arrihet në *heshtim*, akt gjatë të cilit “*realizohet heqja tërësore e shenjave*”.<sup>22</sup> Në raste të tjera kur kemi thyerje ligjërimi, kemi të bëjmë nëpërmjet dukurisë së heshtimit me një tjetër rast që quhet *reticencë* ose rastin tjetër *pezullim*: fenomene të zhdukjes së aktit komunikativ – moment që e trajtuam më në krye. Si *litota* në veprën *L. M.*, mund të përmendim rastet: “*Më ké ndejë me 'i gjymsë opinge*”; “*Per me çue 'i grimë bukë te shpija*”. Këto dy shembuj, që u sollën për ilustrim, mendojmë se mjaftojnë për të dalë si kundërpohim i konstatimit të B. Kosumit, i cili shprehet në momentin kur bën krahasimin mes Naim Frashërit dhe Gjergj Fishtës për aspektin figuracional – ose më saktë në përdallimin mes hiperbolës dhe *litotës*: “*Te Fishta është ndryshe. Ai nuk përdorë kurrë*

<sup>21</sup> Bajram Kosumi, *Fishta dhe letërsia shqiptare e traditës*, botimet Filozofia Urbane, Prishtinë, 2013, f. 197.

<sup>22</sup> Arshi Pipa, *Letërsia shqipe: perspektiva shoqërore*, [Trilogjia Albanika III], përk: Myftar Gjana, Princi, Tiranë, 2013, f. 107.

litotën. Figura e tij karakteristike është hiperbola, e formësuar në shumë trajta e përmbajtje”.<sup>23</sup>

Veprat e Fishtës janë të shkuara në gjuhën shqipe, varianti gegë, dhe secila gjini e këtij autori diferencohet për shkak të natyrës së stilit. Pjesë e komunikimit artistik për poetin, është vetë gjuha shqipe me tërë trajtën e saj (huazimet e ndryshme, arkaizmat, etj.), madje në raste të caktuara kemi përdorim edhe të ndonjë varianti gjuhësor në toskërishte.<sup>24</sup> Kjo për arsye të brendshme tekstore e autoriale. Mendojmë se problemin lidhur me përcaktimin e gjuhës fishtiane në poemën e vet, e kanë shteruar edhe studiues të tjerë të traditës. Fjala vjen, Koliqi e ka mjaft të qartë interpretimin e tij mbi gjuhën e *Lahutës*. Dy shkrimet e tij: “Fishta dhe Malsorët”, “Të të folunit e maleve”, e ndrijnë çështjen e statusit të gjuhës në këtë poemë. Koliqi thotë: “*Me tupa Malsorësh e me gjuhë të maleve Fishta krijoi Kryeveprën e vet, Lahutën e Malcís*”,<sup>25</sup> siç shprehet rishtas: “Fishta, mbassi pat intuicionin gjenial me zgjedhë jetën e maleve si landë për poemën e vet epik, i a vu mendën me kujdes të madh të folunit kumbuer e të fuqishëm të Malsorvet dhe ketë përdori më të shumtën ndër këngë të Lahutës së Malcís”.<sup>26</sup> Kështu, mendimi i dy studiuesve të traditës, Çabej dhe Koliqi, në lidhje me gjuhën e poemës epike të Gjergj Fishtës, na rezultojnë i saktë e i parrëzueshëm. Ideogjeneza për përvetësimin e një statusi të tillë gjuhe për *L. M.*, duhet parë edhe në botimet e para tek faqet e “Albania”-s me titull: *Këngë malcorisht* me pseudonim (*Këngë mirditisht*, dy numra më herët) e vijimisht me *Këngë popullore* deri kur vjen titulli përfundimtar i kësaj poeme: *Lahuta e Malcís*.

---

<sup>23</sup> Po aty.

<sup>24</sup> Khs.: “*Sa qi ushtue ká hapësira: / A po ndien, moj t’raftë e mira!*”; “*Nper atò breshtha të larta, / Siellej Shkjau, si shkerbé malí*”. Át Gjergj Fishta, *Lahuta e Malcís*, Botimet françeskane, bot. XV (anastatik i 1937 + fjalori i Át Benedikt Demës dhe parathanja e Át Zef Pllumit), Shkodër, 2006, f. 94 dhe 100. Citimet kudo nga *L. M.* janë prej këtij varianti, për rrjedhojë nuk do jepen të gjithë treguesit e burimit në vazhdim.

<sup>25</sup> Ernest Koliqi, *Syzime letrare (Fishta dhe Malsorët) Vepra 5*, Faik Konica, Prishtinë, 2003, f. 54.

<sup>26</sup> Po aty (*Të të folunit e malevet*), f. 56.

## KREU III

### Hiperbola si figurë e rëndësishme e poetikës së Fishtës në epikë: funksioni i saj

Figura e hiperbolës shfaqet konsiderueshëm në poemën epike *Lahuta e Malcís*, dhe kryen një rëndësi të veçantë në poetikën e kësaj vepre. Denduria e pranisë së kësaj figure, mbase përbën shkallën më të lartë paraqitëse së bashku me figurën e krahasimit, në raport me figurat e tjera. Hiperbola, siç e pamë në hyrje, klasifikohet në familjen e metalogjizmave. Ajo mund të jetë tipologjikisht disadorësh dhe mund të dalë e shoqëruar me figura të rretheve të tjera. Duke vërejtur anatominë e saj si trop, rezulton që ajo të përfaqësohet me funksione të ndryshme të ligjëritimit<sup>27</sup> përpara se të jetë mirëfilli pjesë studimore e letërsisë. Çka na intereson neve, natyrisht, është paraqitja e saj në raport me letërsinë e konkretisht në poemën e Gjergj Fishtës, *L. M. Megjithëse* në raste të caktuara raporti i shpërfaqjes së hiperbolës në letërsi është i ndërlidhur me natyrën e pranisë së saj jashtë marrëdhënies letrare. Kështu aspekti familjar i tyre, gjatë përdorimit në gjuhën joletrare, i ka shndërruar ato në shprehje të gatshme (ose idiomatike herë-herë) duke kontribuar në konvencionalitetin e tyre. Me *hiperbola konvencionale*,<sup>28</sup> do të kuptojmë atë korpus të hiperbolave që kanë përdorim të shpeshtë në gjuhën bisedore/jobisedore apo gjenden në fjalorë të ndryshëm. Në veprën e Fishtës, kryesisht si hiperbola konvencionale, konsiderohen hiperbolat të cilat në vetvete janë numerike, ose mbështetën në shprehje frazeologjike. Për shembull një shprehje e tillë si: “*T’u çue m’ kambë të tanë Kosova*” ose “*Njimí pushkë i çoi Cetina*”, dëshmon për një trajtë konvencionale të shprehjes hiperbolike. Vargu në rrafsh logjik del afunksional, sepse nuk mund të ngrihet në këmbë krejt Kosova, por poetikisht ai (vargu) funksionon si figurë letrare: hiperbolë. Ndërsa rasti tjetër, ka të bëjë me hiperbolën e cila ndërtohet në sajë të numrave që paraqiten për nga sasia të lartë, kryesisht të formuar me qindëshe (*shtatëqind, tetëqind, nëntëqind* etj.), p. sh.: “*Cetinjanë nja shtatqind vetë*”; “*Tetqind pushkë, t’ gjith djelm të rí*”; “*Ndandqind pushkë ka qitë Nikshiqi*”). Përpara se të shkojmë në analizë të mëtejshme, lipset që këtu të bëjmë një diferencim tjetër. Ka momente të caktuara në veprën *L. M.*, që mes kontekstit dhe shprehjes hiperbolike, ka një dasí të dhënë. Duhet shqyrtuar mirë fakti nëse

<sup>27</sup> Khs.: “Hyperbole is the traditional term taken originally from classical rhetoric and thus is associated with formal and persuasive speech, later with stylistics and literature”. Claudia Claridge, *Hyperbole in English. A Corpus-based Study of Exaggeration*, Cambridge University Press, 2011, f. 6.

<sup>28</sup> Shih: kap. 6.1 të Claridge *Conventional hyperbole* “These are forms which one has heard quite often, uses oneself or which are even listed in dictionaries”, *ibid.*, f. 170.

konteksti mund të rezultojnë i vërtetë. Meqenëse poema lidhet me caqe të caktuara historike, me një nga luftërat e vona, ka gjasa që konteksti të mos e përlijë kurdo figurën e hiperbolës. Prandaj ka raste që hiperbola të tilla të rezultojnë të rreme. Për aspektin e hiperbolës së rreme mund t'i referohemi një shembulli hipotetik. Të paramendojmë se në *Lahutë* kemi të bëjmë me një varg, të ndërtuar në sajë të hiperbolës konvencionale: “*x* (= një *x* hero) *asht dy metra i gjatë në kambë*”. Para nesh na del një problem në identifikimin dhe konsiderimin e këtij vargu si shprehje hiperbolike. Ne nuk mund të kemi siguri se ky *x* hero hipotetik nuk e paska pasur atë përmasë trupore. Kështu që, përtej këtij shembulli, në punën tonë hulumtuese për figurën e hiperbolës dhe të krahasimit, vargjet që përbëjnë nivele dyshimi, pasigurie nuk i kemi cilësuar si të mundshme që t'i integrojmë në analizën dhe klasifikimin tonë tropologjik dhe atë tipologjik. Shumë e rëndësishme në rastin e përdorimit të hiperbolës është ekuilibri i saj dhe aspekti latent i shfaqjes së saj, sikundër pohon Pseudo-Longini:

*Nevojitet të dimë cilët janë caqet e secilës shprehje, sepse tejkalimi asgjëson efektin e hiperbolave, e nëse këto gjëra janë tepër të tendosura, arrijnë të ngadalësohen e ndonjëherë marrin efektin e kundërt. [...] I njëjti diskutim që kemi bërë për figurat e tjera vlen gjithashtu për hiperbolat: më të mirat janë ato që nuk duken se janë hiperbola.<sup>29</sup>*

Në veprën e Fishtës, kjo figurë dallohet si për ekuilibrimet e saj ashtu dhe tejkalimet e saj (sidomos në përshkrimet e skenave të luftës). Po kështu, kahja e fshehtësisë së hiperbolës, mund të na rezultojë në një sërë vargjesh, të cilat u përkasin sidomos ligjërit figurativ konvencional (shprehjeve frazeologjike etj.). Hiperbolën, në lëndën poetike të *Lahutës së Malcís*, mund ta klasifikojmë për nga lloji (ndërtimi) në dy ndarje: **a**. *hiperbolë e pastër*, **b**. *hiperbolë e kombinuar*, të cilat në vetvete brendësojnë dy trajta konstruktive: **a1**. *hiperbolë e thjeshtë*, **b1**. *hiperbolë e përbërë*.<sup>30</sup> Për të dhënë një ilustrim, lidhur më këto dy ndarje e dy trajta, sa i takon rastit të ndërtimit të hiperbolës së pastër (të thjeshtë), po marrim një shembull nga kënga *Vranina*: “*Edhë, thonë, ká lé drangue, / Pse trí zëmra i kan qillue*”. Pikësëpari duhet të kuptojmë se procedimi i hiperbolës, është një procedim *sekuencial*: pra, realizimi i saj priret të jetë në një sekuencë të caktuar vargu. Konkretisht, në vargun e parë (në këtë rast) hiperbolën e ndërton leksema *drangue*, ndërsa në vargun e dytë numërori *trí*. Gjymtyrët e tjerë të vargut nuk luajnë ndonjë funksion bashkëveprues në operimin e

<sup>29</sup> Pseudo-Longini, *E madhërishmja* (kap. XXXVIII), përkthyer: Lisandri Kola; Vinçens Marku, Enti botues “Gjergj Fishta”, Lezhë, 2009, f. 91.

<sup>30</sup> Khs.: “*Those cases in which hyperbole combines with another process or figure of speech will be termed composite hyperbole*”, *ibid.*, f. 41.

shndërrimit logjik/figurativ të vargut. Kurse për rastin e ndërtimit të hiperbolës së kombinuar (të përbërë), po marrim dy vargje nga kënga *Preja*: “*Edhë ushtoi duhma e breshânës / Me u dridhë fmija n’ zëmer t’ nânës*”. Të ndalemi vetëm tek vargu i parë. Nëse do të kishim raporte të tilla të ndërtimit të vargut, rezultati do të ishte ky:

1. *Edhë ushtoi krisma e breshânës...* = varg pa ndonjë ngjyresë figuracionale
2. *Edhë erdh duhma e breshânës...* = varg pa ndonjë ngjyresë figuracionale

Në veprën *Lahuta e Malcís*, por edhe si figurë, hiperbola, ka një efekt të sajën çka ndihmon në intensifikimin emocional të receptuesit. Efekti hiperbolik, lidhet në krye të herës me lëndën ku ajo është e stabilizuar (në produkt epik) dhe me aftësinë autoriale për ta ndërtuar atë. Shumë konstrukte të vargjeve, me bazë ndërtuese hiperbolën, mundësojnë funksionalitetin empatik mes veprës që përçohet dhe lëndës që merret. Ky funksionalitet mund të nisë qysh në paraqitjet e konstrukteve të thjeshta deri tek ato të përbërat. Ndodh që edhe një heshtim (grafikisht i paraqitur me trepikësh) të jetë hiperbolik. Në sajë të pushimit (pauzës) që krijohet, duke respektuar vullnetin autorial për pezullimin e aktit komunikativ, hiperbola merr përmasa të reja, të cilat në psiken e lexuesit/dëgjuesit ndërtojnë shëmbëllime mbase edhe më akute sesa përmbante vargu hiperbolik që përmbyllej me heshtim (reticencë). Të marrim disa vargje, në të cilat del kjo dukuri:

*Kshtû tha Mashi e Krenët e Hotit*

*Si t’ u ráke ’i rrfé prej Zotit,*

*N’ ato fjalë mbeten pa zâ : [pá]*

*Me i pasë pré... gjak s’ kishin bâ.*

(L. M., XIII, ff. 143-144)<sup>31</sup>

### 3.1 Rastet e ndërtimit të hiperbolës në *Lahutën e Malcís*

Sa u takon rasteve të ndërtimit të figurës së hiperbolës, mund të themi se ato janë të klasifikuara në disa ndarje kryesore. Në ndarjen e parë, do të klasifikojmë hiperbolën që ndërtohet në bazë të personazheve të *Lahutës së Malcís*. Personazhet, siç dihet, ndahen në protagonistë dhe antagonistë. Tek hiperbola me bazë ndërtuese *protagonistët*, integrohet lloji hiperbolës *përlëvduese*. Ndërsa në hiperbolën me bazë ndërtuese *antagonistët*, integrohet e

<sup>31</sup> Po aty, nr. 3, *Muji te Mbreti*, f. 20.

kundërta e hiperbolës përlëvduese: ajo *përkeqësuese*. Por, sikundër e shprehem gjatë trajtesës, jo gjithëherë mund të kemi trajtën e hiperbolës përkeqësuese për rastin e antagonistëve. Po kështu në këtë ndarje, do të përfshijmë dhe procedimin e pjesshëm të hiperbolës gjatë vargut, e cila bazohet mbi ndërtimin e *foljes*. Ndryshe nga procedimi me natyrë tërësore a përmbledhëse të një vargu (si me protagonistët/antagonistët), këtu sekuencialiteti është tipar sundues. Vetëm me anë të një pjesë të ligjëratës mund të rezultojë se kemi të bëjmë me kompozim hiperbole. Ndryshe është rasti i shndërrimit frazal, i cili ndikon në tjetërsimin e rendit sintaksor në krejt marrëdhënien e vargut. Bëhet fjalë kështu për *hiperbolën inverson*, e cila gjen raste përdorimi në poemën fishtiane. Rastet e këtij tipi mbase nuk janë aq dominante, por janë mjaftueshëm të pranishme sa për t'u marrë në analizë dhe për të krijuar një identitet hiperbole. Në ndarjen e dytë, do të integrojmë rastet e hiperbolës që ndërtohen me figura të ndryshme poetike. Bivalenca i referohet kryesisht frekuencës më të lartë të disa figurave, të cilat dalin dukshëm në poemë. Të tilla figura janë: *anafora*, *anadiploza*, *polisindet*. Këtyre u bashkëngjiten disa raste të tjera të bivalencës si: hiperbola *numerike*, *metaforike* etj. Një dallim kryesor që do të bëhet në këtë rast, është mes hiperbolës dhe të kundërtës së saj: *litotës*. Dallimi do t'i referohet tipologjisë dhe intensitetit të përdorimit në lëndën poetike. Ekzistenca e litotës, në *Lahutë*, nuk shquhet për ndonjë dendësi të mirëfilltë, por ajo mund të inkuadrohet si tërësi e korpusit figuracional që gjendet në poemë. Pjesa tjetër do t'i kushtohet tipit të *hiperbolës burleskore*. Fillimisht trajtimi do të nisë me këngën *Lugati*, për të pasur me afritë dhe dallimet mes këtij tipi të hiperbolës në epikë dhe satirë. Konkretisht vënia përballë do të jetë mes: *Kuvendit të Berlinit* dhe *Nikolejdës*. Në pjesën e fundit do të merremi me figurën e hiperbolës në përgjithësi, e cila gjen shtrirje në produktin epik të Gjergj Fishtës. Kështu, kjo figurë do të krahasohet edhe me veprën epike të pambaruar *Mojs Golemi i Dibers e Deli Cena*, mbi bazën e strukturës dhe funksionit të saj. Procedimi mbi këtë veper parashikohet të jetë në analogji me të njëjtin procedim që patëm për veprën *Lahuta e Malcís*. Njëkohësisht raporti protagonist dhe antagonist, sikundër hiperbola përlëvduese dhe përkeqësuese do të vështrohen në tërësinë e lëndës epike *Mojs Golemi i Dibers e Deli Cena*.

### **3.2 Krahasimi si figurë e rëndësishme e poetikës së Fishtës në epikë: funksioni i tij**

Figura e krahasimit bën pjesë në rrethin e metasememave, dhe në tërësinë e lëndës së poemës epike *Lahuta e Malcís*, ai ka një funksion kyç. Denduria e përdorimit të kësaj figure është mjaft e konsiderueshme. Së bashku me hiperbolën (e me një korpus tjetër figurativ), ato përbëjnë grupin e figurave me frekuencën më të lartë në veprën fishtiane. Struktura e tij

ndahet në dy kategori kryesore. Krahasimi mund të jetë i realizuar me konstrukte të thjeshta ose të përbëra, të cilat përkatësisht ndërtojnë klasën e *monovalencave* dhe të *valencave çifte*. Tek konstruktet e thjeshta, dallojmë dy trajta ndërtimore me prani gramatikale:

1. krahasimin cilësor (i ndërtuar përmes lidhëzës *si*, që mund të ketë derivatet e tij analogjike *sikur*, *porsi* etj.) i cili është më i zakonshmi;

2. krahasimin sasior (i ndërtuar përmes lidhëzës *sa*). Ndërsa në konstruktet e përbëra veçohen ndërtimet e ndërlikuara strukturore nëpërmjet tropeve të ndryshme, që bëjnë pjesë në rrethet gjegjëse. Po kështu, në poemën e Fishtës vërehet dhe përdorimi I krahasimit si strukturë e zgjeruar, ose i *similitudës* thënë ndryshe. Tek tipologjia e krahasimit do të dallojmë ndër të tjera *gjurmën e krahasimit*, e cila konsiston në një prani lidhëze të munguar, që menduam ta emërojmë “*gjurmë*”. Kjo *prani e munguar* e gjymtyrës lidhëzore që ndërton krahasimin, integron brenda vetvetes një trajtë procesi të eliptimit të presupozuar. Elipsa si metabolë e metatakës (e kategorizuar te heqja tërësore e strukturës së frazës), rezulton e pranishme në këtë shndërrim të vargut. Të marrim një rast: “*Edhë m’ shpinë aj ° zhgjetë i u lshue / Me djelm t’ vet, porsi ‘i terbue*”. Siç shihet gjurma e krahasimit (°) del në kontekstin e fshirjes totale – dukuria e *blanchissement-it*.

Veç këtij fakti, gjurma e krahasimit del e pranishme në një konstrukt vargu, që i përket krahasimit konvencional (cilësor): “*U lshue/shkoi/fluturoi si zhgjetë*”. Kryesisht në *L. M.*, gjurma e krahasimit parakupton një krahasim cilësor të fshirë. Shembujt me krahasim sasior të fshirë, janë shumë pak ekzistentë. Eliminimi i gjymtyrës (si njësi gramatikore po flasim) krahasuese, në disa prej vargjeve të *Lahutës*, vjen edhe si rezultat i kompensimit të masës metrike. Domethënë është një zgjidhje teknike e autorit për të realizuar masën konsekuente të metrit të veprës. Ky model i ndërtimit të vargut, duhet thënë se ka një grup të caktuar struktural, në të cilin operohet. Prandaj jo rrallëherë, ndeshen shembuj analogë vargjesh, të cilët përfshijnë gjurmën e krahasimit.

Në mbarë korpusin e krahasimit, që kemi dalluar në poemën fishtiane, funksioni I kësaj figure përkon simbas strukturës kontekstuale të tij. Kështu, nëse kemi një ndërtim vargu me krahasim cilësor, krahasimi mund të jetë mes objekteve, personazheve, etj., të varura në marrëdhënie cilësie mes tyre. Ndërsa kur kemi të bëjmë me rastin e krahasimit sasior, krahasimi varet prej marrëdhënies së sasisë (masës) a përpjesëtimit. Këto u përkasin konstrukteve të thjeshta, elementare të tipit të krahasimit. Për rrjedhojë procedimi në tjetërsimin e strukturës është minimal (në *folje*, *emër* etj., si tek rastet e hiperbolës). Tek



strukturat e përbëra funksioni i krahasimit varet sipas figurës që integrin në vete, dhe kontekstit të përgjithshëm të sekuencës në të cilën paraqitet kjo figurë. Funksioni i tyre mund të përdoret për personazhet e veprës, skenat epike e me radhë. Në tërësinë e figurave që përfshihen tek krahasimi, me rëndësi shfaqet tipologjia e krahasimit hiperbolik (ose krahasim metalogjik) e cila përbën një operim sintezë. Kemi kështu një bashkëprani apo bashkëshkrimje të këtyre dy figurave kryesore të epikës së Fishtës.

Duke ekzistuar në vargje të dhëna një tipologji e tillë, efektet e imazhit poetik paraqiten me gradacion më të lartë emocional. Krahasimi hiperbolik, pos tjerash, në një pjesë të mirë të rasteve është shndërruar në krahasim konvencional, i cili vetë mund të parakuptojë integrimin e njësisë frazeologjike – të strukturave të ngurtësuara në ligjërim. Këto struktura të ngurtësuara janë bërë pjesë edhe e gjuhës poetike. Në këtë mënyrë, komunikimi mes tekstit fishtian dhe receptuesit bëhet me ndërmjetësim më të lehtësuar për shkak të këtyre konstrukteve të zakonshme, familjare. Një tjetër çështje që del në këtë poemë, është përsëritja e figurës së krahasimit: pra, kemi struktura intersimetrike me dendësi jo të paktë. Ky problem na çon në një diskutim konkret. Fakti i përsëritjes së strukturave figurative (në rastin tonë: krahasimit) është një dukuri që pranohet në epos apo është një e metë e autorit? Për t'i dhënë përgjigje kësaj pyetjeje, duhet t'i drejtohem fillimisht grupit të ngjashëm të strukturës së krahasimit, të hetojmë nivelin e frekuencës së këtyre strukturave dhe të shohim kontekstet e caktuara në të cilat janë aplikuar këto struktura. Nga studimet e kryera për çështjen e përsëritjes në epikë (*ripetitio epica*),<sup>32</sup> është pranuar një përlligje për disa njësi përsëritëse në një vepër epike. Kryesisht pranimi i përsëritjes është për strukturat formulative hyrëse,<sup>33</sup> është pranuar një përlligje për disa njësi përsëritëse në një vepër epike. Kryesisht pranimi i përsëritjes është për strukturat formulative hyrëse, të cilat gjenden në këngët shqipe rapsodike dhe që dalin të pranishme në një sërë vargjesh të Lahutës. Këto struktura hyrëse zakonisht janë njëvargëshe, e pikëpjekën me trajtat formulative të veprave klasike.<sup>34</sup> Por, shembulli i përsëritjes së strukturave simetrike të figurës së krahasimit, brenda poemës *L. M.*, nuk ka të bëjë me përsëritje rimarrëse të këtij niveli. Ajo pjesë e ndërtimeve analoge të krahasimit,

---

<sup>32</sup> Khs. Gjergj Zheji, *Bazat e vargëzimit shqiptar*, Rilindja, Prishtinë, 1990, f. 351: “Përsëritja e vargjeve në të ashtuquajturën repetitio epica, përbën një formulësim shumë të përhapur në krejt poezinë tonë epike popullore”.

<sup>33</sup> Ose në “introduksionin karakteristik” siç shprehet muzikologu Tonin Daija, në: *Fjala, tingulli, metrika në “Lahuten e Malcis”*, Botimet françeskanë, Shkodër, 2004, f. 25. Një studiues tjetër, i cilëson si “figura klishe”: “Një veçori e poetikës së rapsodive është përdorimi i gjerë i disa formulave e i grupimeve të vargjeve e shprehjeve artistike, që përsëritën [...] duke formuar kështu të ashtuquajturën figura klishe”, Fadil Podgorica, “Natyra dhe funksioni i figurave klishe në epikën heroike shqiptare”, *Çështje të folklorit shqiptar 2*, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Kulturës Popullore, Tiranë, 1986, f. 343.

<sup>34</sup> Shih për më tepër Gj. Zhejin, *ibid.*, f. 349.

paraqitet si konstrukt “kalk”. Të krahasojmë për shembull: “*Tue flutruet si gjeraçinë | Me flutruet si gjeraçinë; T’ idhtë si gjarpni nder kaçuba | Idhtë si gjarpni neper firi*” etj. Prandaj, mbase për shumë shkaqe që lidhen me masën e vëllimit të lëndës së *Lahutës*, këto struktura analoge intersimetrike të krahasimit mund të cilësohen si e metë autoriale. Përsëritja e tyre vjen si një familjarizim me një sërë strukturash stereotipale, nga ana e autorit. Pastaj aspekti i rimës, kryen një tjetër nevojë të përdorimit të këtij korpusi strukturor.

Disa nga tipat e krahasimit, që në fakt shprehin shkallën e krahasimit, në poemën fishtiane ndeshen shumë pak. Struktura të tipit *më mirë se ose më mirë... se...* i hasim krejt rrallë. P. sh.:

*Mâ mirë n’ vorr m’ u kja per mâll,*

*Se nën Shkjâ me ndëjë per t’ gjallë !*

(L. M., VIII, f. 83)

Kemi një varg tjetër, po ashtu, i cili shpreh shkallën sipërore të mbiemrave cilësorë dhe njëkohësisht nivelin e krahasimit. Është fjala për krahasimin që i bëhet Tringës: “*Se një vashë mâ t’ mirë s’ e shef*” (L. M., XXII, f. 325). Gjithsesi dhe ky shembull përbën prani të vogël, thuajse të pavënëre. E njëjta gjë ndodh dhe me ndajfoljet *fort/shumë*, të cilat dalin në funksionin e shkallës krahasore të ndajfoljeve:

a. *Ket qyqâr, thom, e vrau vehtja ;*

(L. M., XIV, f. 156)

b. *Jo mâ shum se ’i ditë a dý*

(L. M., XXI, f. 288)

Këto shembuj që u morën në analizë, përbëjnë një korpus të veçantë të figurës së krahasimit e cila del e bashkërenduar me elementë gramatikorë.<sup>35</sup>

### 3.3. Rastet e ndërtimit të krahasimit në *Lahutën e Malcís*

Gjatë kërkimit mbi ndërtimin, natyrën e figurës së krahasimit në *Lahutën e Malcís*, na kanë rezultuar disa struktura dhe lloje krahasimesh. Në strukturën e thjeshtë të figurës së krahasimit, renditen procedimet në nivel minimal të ndërhyrjes në tërësinë e konstruktit të

<sup>35</sup> Një shembull tjetër mund të marrim vv.: “*Prande’, ashtû si m’ duket mue; Knjazi ashtû si e kisht’ qortue; Njashtû si per k[â]mbet berrin !*”, të cilët kanë një kufizim në përdorim.

vargut. Këto procedime parashikohen të jenë në dy njësi bazike (klasa fjalësh): **a.** në *folje*; **b.** në *emra*. Një aspekt i tillë procedimi paraqitet me përmasa elementare të tjetërsimit. Po në këtë grup renditet dhe një varg unik i ndërtimit të krahasimit, i cili paraqitet si *krahasim hidronimik* e njëherësh si varg i përfshirë në vargun leonin ose jo. Tek strukturat e thjeshta përfshihen dhe dy modelet e krahasimit:  *modeli cilësor* dhe  *modeli sasior*, të cilët dalin në struktura të pranëvëna me njëra-tjetrën e me një hapësirë vepruese në poemën epike *L. M.* Po kështu në këtë grup do të rendisim  *gjurmën e krahasimit*, e cila përbën një veçanti ndërtimore. Kurse në strukturat e përbëra të krahasimit, rendisim një sërë figurash që integrohen brenda konstruktit të krahasimi (klasa me valenca çifte), si:  *anafora*,  *epiteti*,  *anadiploza*,  *krahasimi metaforik*;  *krahasimi hiperbolik*. Llojet e krahasimeve të strukturës së përbërë, ndërtojnë në këtë mënyrë një personalizim autorial dhe një specifikë konkrete në lëndën epike. Krahasimi si figurë letrare shpërfaqet me bazë ndërtimi personazhet e veprës fishtiane. Për rrjedhojë do të kemi krahasimin me bazë ndërtuese  *protagonistët* dhe  *antagonistët*.

Duke u nisur prej përdorimit të këtillë, secili nga natyrat e krahasimit ka një tipologji të vetën, por në vargje të caktuara kemi të bëjmë dhe me një procedim të ndërmjetëm. Ndërmjetësia procedurale shtrihet në bashkekzistencën e strukturave që mund të përdoren nga poeti si për protagonistët ashtu dhe për antagonistët. Një fakt të ngjashëm e kishim dhe në rastin e figurës së hiperbolës. Në kompozimet e krahasimi (protagonistë vs. antagonistë) nuk do të hetojmë qasjen opozicionale – përlëvdues vs. përkeqësues, për shkak se materiali nuk na e mundëson edhe aq një gjë të tillë. Si një strukturë më vete na paraqitet ajo tërësi vargjesh, që ndërtohet me anën e figures mitike: *Zâna*.

Një ndërtim i tillë rrok disa lloje konstruktesh, të cilat mbështeten në përmbajtje domethënieje:

1. me domethënieje të trimërisë;
2. me domethënieje të bukurisë.

Këto janë strukturat themelore, në të cilat paraqitet si gjymtyrë e ndërfutur figura e *Zânës*. Ndërtimi i krahasimit mbi këtë figurë mitologjike, në shumicën e rasteve është me emër të përgjithshëm. Shembujt me emër të përveçëm kanë një shpeshti minimale. Edhe pse një krahasim, i mbështetur në sferën mitologjike, etnike ai tashmë klasifikohet në kategorinë e  *krahasimeve konvencionale*, meqenëse është stabilizuar në njësi frazeologjike: *E bukur si*

zanë; *Trim si zanë* etj. Strukturat e ndërlikuara ose të zgjeruara të krahasimit (*similitudat*) kanë një denduri relative në *Lahutë*, të cilat intensifikojnë dispozitat figuracionale si dhe forcën shprehëse të vargut epik. Përdorimi i similitudës në veprën fishtiane është tregues i prezencës tradicionale në gjininë e epikës, me kontakte të prodhimeve brenda sistemit shqiptar e jashtë sistemit shqiptar. Këto pikëtakime nuk do të jenë të pranishme në këtë pjesë të dytë të tezës, por në atë të mbramen, në të cilën do të gjurmohen afritë e dallimet mes traditës parafishtiane e asaj fishtiane. Aspektit *intersimetrik* të strukturave të krahasimit, do t'i kushtohet një vëmendje e posaçme sikundër krahasimit mes prodhimit epik të Gjergj Fishtës. Kësisoj figura e krahasimit (në tërësinë e tij strukturale) do të vështrohet në kahe përqasëse mes *Lahutës së Malcís* dhe *Mojs Golemit të Dibers e Delì Cenës*. Brenda për brenda prodhimit epik të këtij autori, do të kërkohet të dallohen njësitë konverguese e diverguese të strukturave të krahasimit.<sup>36</sup>

---

<sup>36</sup> Gj. Zheji, (kap. 11. *Formulësimet*) *ibid.*, f. 347.

## PËRFUNDIME:

Studimi tropologjik i veprës *Lahuta e Malcís* si dhe i gjithë korpusit letrar të Gjergj Fishtës, vijon të jetë ende sot një ndër çështjet më problematike të fishtologjisë. I njëjti pohim mund të bëhet pothuajse për mbarë traditën letrare shqiptare në përgjithësi. Rezultati i punës për interpretimin dhe klasifikimin e tropeve fishtiane, është mjaftuar në kontribute të pjesshme jo specifike. Më së shumti, trajtimet e figurave letrare kanë përbërë sythe artikujsh a monografish, pothuaj gjithherë të kufizuar në shtrirje e jo të qenësishëm në pikëpamje të gjerësisë e të thellësisë së shqyrtimit. Një mungesë e tillë paraqitet, për shkak të interesimit të zakonshëm panoramik që ka dominuar në njohjen shkencore mbi veprën poetike të Fishtës.

Nga një sërë qështjesh analitike mbi zhvillimet historike të letërsisë shqipe, bazuar dhe koncepte teorike mbi gjinitë, konkludojmë që *Lahuta* është vepra me pozicion qendror në sistemin letrar shqiptar, vepra model i parë epike në historinë e letërsisë sonë, po të shpreheshim me termat e Frait, *Lahuta* është plotësuese gjinore e epikës.

Lirika fetare e Fishtës kur propagandon e predikon, kur është në shërbim drejtpërdrejt të kishës kotolike, veçanërisht françeskane, del jashtë funksionit letrar. Ajo merr tiparet e një teksti të angazhuar, ideologjik, didaktiv e edukativ, që mund të këndohet e recitohet fare mirë në koret e kishës. Si tekste mirëfilli religjioze e më pas letrare, një pjesë e lirikave tentojnë kontaktin e drejtpërdrejt me lexuesin, (auditorin) duke drejtuar atij me thirje profetizuese.

Duke qenë i tillë, ai si duket i kishte vënë vetes detyrë që të shndërrohej në sogjetar të atdheut të rrezikuar dhe i pamëshirshëm me zemërimin e vet ndaj çdo kujt që në një formë ose në një tjetër i binte ndesh të drejtës dhe mbrohtësisë së atdheut të tij.

Duhet përmendur edhe këtë: Poeti nacional, At Gjergj Fishta, kandidat për çmimin “Nobël” në vitin 1938, në epopenë “*Lahuta e Malcís*”, na jep dhe aktin e fundit dramatik të kullës: kjo nuk bën të bjerë në dorë të armikut.

## BIBLIOGRAFIA:

1. “fjalë që rimon me veten e saj”, shih: Arshi Pipa, Vargu folklorik shqip: ndërtimi dhe gjinitë, [Trilogjia Albanika I], përk.: Primo Shllaku, Princi, Tiranë, 2013, f. 24.
2. “Hiperbola është figura më karakteristike e Fishtës dhe ajo shpreh gjërat më të mëdha sesa janë në përmasat reale, shpreh madhështinë dhe botën e madhe shqiptare”, B. Kosumi, Fishta dhe letërsia..., ibid., f. 280.
3. Akademia e Shkencave, Instituti i gjuhësisë dhe i letërsisë, Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Filologjisë, Seminari XVIII ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare, Toena, Tiranë, 1996, f. 1023.
4. Arshi Pipa, Letërsia shqipe: perspektiva shoqërore, [Trilogjia Albanika III], përk: Myftar Gjana, Princi, Tiranë, 2013, f. 107.
5. Bajram Kosumi, Fishta dhe letërsia shqiptare e traditës, botimet Filozofia Urbane, Prishtinë, 2013, f. 108.
6. Bajram Kosumi, Fishta dhe tradita letrare shqiptare, Brezi 81, Prishtinë, 2012.
7. Dr. Xhavit Aliçkaj, Lahuta e Malcis e Gjergj Fishtës, Faik Konica, Prishtinë, 2000, f. 226.
8. Ernest Koliqi, Syzime letrare (Fishta dhe Malsorët) Vepra 5, Faik Konica, Prishtinë, 2003, f. 54.
9. J. A. Cuddon, (revised by C. E. Preston) Dictionary of literary terms and literary theory, Penguin books, England, 1999, f. 47: “*antonomasia* (Gk ‘naming instead’) A figure of speech in which an epithet, or the name of an office or dignity is substituted for a proper name”.
10. Ka botime artikujsh (përmbledhje) edhe të mëpërparshëm se këto, siç kemi rastin e HD, vjeti VII, nr. 10, Tetuer 1931. Përmbledhje artikujsh në nderim të 60 vjetorit të lindjes së Fishtës. Duke qenë ende para botimit përfundimtar të Lahutës, ky numër i kësaj reviste, paraqitet më i paplotë sesa ato realizuar mbas vdekjes së autorit të saj.
11. Khs. Gjergj Zheji, Bazat e vargëzimit shqiptar, Rilindja, Prishtinë, 1990, f. 351: “Përsëritja e vargjeve në të ashtuquajturën *repetitio epica*, përbën një formulësim shumë të përhapur në krejt poezinë tonë epike popullore”.
12. Khs. HD, vjeti XX, nr. 5, Mâj 1944, ff. 19-27.
13. Khs. për më shumë Gruppo  $\mu$ , ibid., f. 161.
14. Khs.: “Hyperbole is the traditional term taken originally from classical rhetoric and thus is associated with formal and persuasive speech, later with stylistics and literature”. Claudia Claridge, *Hyperbole in English. A Corpus-based Study of Exaggeration*, Cambridge University Press, 2011, f. 6.
15. Khs.: “Sa qi ushtue ká hapesira: / A po ndien, moj t’raftë e mira!”; “Nper atò breshta të larta, / Siellej Shkjau, si shkerbé mali”. Át Gjergj Fishta, Lahuta e Malcís, Botimet françeskane, bot. XV (anastatik i 1937 + fjalori i Át Benedikt Demës dhe parathanja e Át Zef Pllumit), Shkodër, 2006, f. 94 dhe 100. Citimet kudo nga L. M. janë prej këtij varianti, për rrjedhojë nuk do jepen të gjithë treguesit e burimit në vazhdim.
16. Khs.: “Those cases in which hyperbole combines with another process or figure of speech will be termed composite hyperbole”, ibid., f. 41.
17. Kolë Kamsi, “Vepra poetike e Fishtës e kritika”, përfshirë në: Át Benedikt Dema, O. F. M., Át Gjergj Fishta O. F. M. 1871-1940..., f. 171.
18. Lili Sula, “Receptimi kritik i Fishtës në periudhën 1944-1990” në: Fishta - poeti dhe mendimtari kombëtar, Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, Fakulteti i Shkencave Shoqërore, Studime shqiptare 18, Shkodër, 2011, f. 106.
19. Lili Sula, 100 vjet shkrime për Fishtën (1904-2004), Skanderbeg books, Tiranë, 2009.

20. Martin Camaj, “Shëndrrimi e përpunimi i thanjeve popullore në Lahutën e Malcís”, “Shêjzat”/“Le Pleiadi”, Anno V, Romë, 1961/11-12 dhe Martin Camaj, “Kumtime të reja mbi Fishtë”, “Shêjzat”/“Le Pleiadi”, Romë, 1962/9-10.
21. Një shembull tjetër mund të marrim vv.: “Prande’, **ashtë si** m’ duket mue; Knjazi **ashtë si** e kishtë qortue; **Njashhtë si** per k[â]mbet berrin !”, të cilët kanë një kufizim në përdorim.
22. Ose në “introduksionin karakteristik” siç shprehet muzikologu Tonin Daija, në: Fjala, tingulli, metrika në “Lahuten e Malcís”, Botimet françeskane, Shkodër, 2004, f. 25. Një studiues tjetër, i cilëson si “figura klishe”: “Një veçori e poetikës së rapsodive është përdorimi i gjerë i disa formulave e i grupimeve të vargjeve e shprehjeve artistike, që përsëritën [...] duke formuar kështu të ashtuquajturën figura klishe”, Fadil Podgorica, “Natyra dhe funksioni i figurave klishe në epikën heroike shqiptare”, Çështje të folklorit shqiptar 2, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Kulturës Popullore, Tiranë, 1986, f. 343.
23. Pseudo-Longini, E madhërishmja (kap. XXXVIII), përkthyer: Lisandri Kola; Vinçens Marku, Enti botues “Gjergj Fishta”, Lezhë, 2009, f. 91.
24. Sabri Hamiti, Studime letrare, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës. Botime të veçanta XLIX, Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Libri 21, Prishtinë, 2003, f. 218.
25. Sabri Hamiti, Utopia letrare, Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës, botime të veçanta CXXIX, Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Libri 49, Prishtinë, 2013, f. 261.
26. Shih për më tepër Gj. Zhejin, ibid., f. 349.
27. Shih: kap. 6.1 të Claridge Conventional hyperbole “These are forms which one has heard quite often, uses oneself or ëhich are even listed in dictionaries”, ibid., f. 170.